banues per qellim te kompetencave perkatese prane shoqerise referuar si me poshte, te cilet marrin pjese ne kete akt ne cilesine e Perfaqesuesve te Posacem me tagra nenshkrimi te perbashket dhe, si te tille, ne perfaqesim te shoqerise "PAUL WURTH ITALIA S.P.A.", me seli ne Genova, via di Francia 1, me kapital ne euro 1.000.000,00 (nje milion euro), teresisht i shlyer, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Dhomes se Tregtise se Genovas me numer 01559640998 (REA 418256), keta perfaqesues jane emeruar me aktin e redaktuar nga une ne daten 17 mars 2017, me numer Repertori 62531, i cili i bashkelidhet ne origjinal ketij akti nen germen "A", leximi i te cilit u anashkalua sipas kerkeses te te Paraqiturve.

Zoternjte e paraqitur, per identitetin personal te se cileve une noteri jam i sigurt, permes deklarimit te tyre se jane shtetas italiane dhe se perfaqesojne nje shoqeri te themeluar rregullisht sipas legjislacionit Italian, deklarojne, ne cilesite e siperpermendura,

themelimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar me nje nivel e emeruar "PAUL WURTH ENERGY S.R.L.", me ortak te vetem shoqerine "PAUL WURTH ITALIA S.P.A.", te perfaqesuar si me siper.

Shoqeria ka seli ne Komunen e Genova, ne adresen via di Francia 1, sic do te rezultoje nga regjistrimi perkates i cili do te kryhet ne Regjistrin Tregtar ne perputhje me nenin 111 ter te dispozitave te zbatimit te Kodit Civil.

Viti i pare financiar do te mbyllet me 31 dhjetor 2017.

Shoqeria do te administrohet per here te pare nga nje Keshill Administrimi, ne fuqi deri ne shkarkim ose doreheqje, ne perberje te se cilit emerohen zoterinjte:

- Thomas Walter HANSMANN, lindur ne Aachen (Gjermani) me 23 tetor 1961, banues ne Gjnove, Viale Arezzo, 5D/7, kod fiskal: HNS TMS 61R23 Z112F, i cilit emerohet ne cilesine e Kryetarit te Keshillit te Administrimit.
- Fabio FABIOLA, ashtu sic eshte paraqitur dhe identifikuar me siper, banues ne Camogli (Gjenove), via G. Bettolo 43/7, kod fiskal: FBL FBA 56S24 B490H.

- Stefano BERTOZZI, ashtu sic eshte paraqitur dhe identifikuar me siper, rezident ne Genova, via Felice Romani 18/6, kod fiskal: BRZ SFN 56T19 D969I.
- Cedric Rudy Henri NEIENS, lindur ne Luksemburg (Luksemburg) me 21 prill 1981, rezident ne Bertrange (Luksemburg) 8, rue Charles Schwal, kod fiskal: NNS CRC 81D21 Z120K.
- Ingo BOTH, lindur ne Neuwied (Gjermani) me 9 dhjetor 1965, banues ne Schweich (Gjermani), Kornblumenweg 2, kod fiskal: BTH NGI 65T09 Z112C.

Kapitali i shoqerise eshte 300.000,00 euro (treqind mije euro) dhe do te neshkruhet dhe shlyhet plotesisht nga ortaku i vetem "PAUL WURTH ITALIA S.P.A." ashtu sic perfaqesohet me siper.

Ortaku i vetem "PAUL WURTH ITALIA S.P.A.", sic perfaqesohet me siper, deklaroi se kjo shlyerje eshte bere permes ceqeve qarkulluese me numer 3900011517-12 dhe 3900011518-00 te leshuara ne daten e sotme nga B.N.L. S.P.A. me urdher te "PAUL WURTH ENERGY S.R.L.", duke mbajtur klauzolen "Patransferueshmeri".

Doktori Fabio Fabiola, ne cilesine e Kryetarit te Keshillit ne Administrimit, deklaroi se ka marre ne dorezim cekun ne fjale dhe ka leshuar faturen liruese, duke vertetuar qe kapitali themeltar eshte shlyer teresisht nga ortaku i vetem.

Doktori Fabio Fabiola autorizohet nga ortaku i vetem per te kryer shlyerjen e kapitalit themeltar te "PAUL WURTH ENERGY S.R.L.", sic u percaktua me siper, ne nje llogari rrjedhese bankare te hapur prane nje Instituti Krediti te parazgjedhur, pas regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar te Dhomes se Tregtise se Genoves.

Zoterinjte e paraqitur, bien dakord qe objekti i aktivitetit dhe rregullat ne lidhje me funksionimin e shoqerise do te jene ato qe rezultojne nga statuti i cili, iu lexua nga une noteri Zoterinjte te paraqitur, u miratua nga ata duke nenshkruar ne thember te cdo faqeje te tij dhe u vulos nga une ne faqet e ndermjetme, bashkelidhet si pjese substanciale e ketij akti nen germen "B"; ky statut permblidhet ne pese flete te shkruara ne nente faqe te plota dhe pjese nga faqja e dhjete.

Pjesemarresit gjithashtu vertetojne se ne marredheniet e punes me shoqerine "PAUL WURTH ENERGY S.R.L." do te zbatohet disiplina e vendosur nga CCNL "Industria e Metalmekanikes dhe Instalimit te impianteve".

Keshilli i Mbiqyrjes perbehet nga tre anetare efektive dhe dy anetare zevendesues.

Ne perberjen e Keshillit te Mbiqyrjes per tre vitet e para financiare, dhe si rrjedhoje deri ne miratimin e bilancit ne 31 dhjetor 2019, emerohen zoterinjte:

- Dr. Pier Luca MAZZA, lindur ne Treviglio (Bergamo) me 31 korrik 1958, banues per shkak te detyres ne Milano, Via Vittor Pisani 16, kod fiskal MZZ PLC 58L31 L400G, regjistruar ne Regjistrin e Auditueve Ligjore me D.M. te 12 prillit 1995, publikuar ne Fletoren Zyrtare nr.31 bis te 21 prillit 1995 – Kryetar i Keshillit Mbiqyrjes.
- Dr. Antonella KOENIG, lindur ne Milano me 21 shkurt 1966, banuese per shkak te detyres ne Milano, Via Vittor Pisani 16, kod fiskal KNG NNL 66B61 F205U, regjistruar ne Regjistrin e Audituesve Ligjore me D.M. te 13 qershorit 1995, publikuar ne Fletoren Zyrtare nr.46 bis te 16 prillit 1995 – Anetar efektiv i Keshillit Mbiqyrjes.

- Dr. Lorenzo RANZA, lindur ne Siracusa me 16 korrik 1974, banues per shkak te detyres ne Milano, Via Vittor Pisani 16, kod fiskal RNZ LNZ 74L16 I754Y, regjistruar ne Regjistrin e Audituesve Ligjore me D.M. te 17 prillit 2007, publikuar ne Fletoren Zyrtare nr.34 te 24 prillit 2007 – Anetar i Keshillit Mbikeqyres.
- Dr. Mosè METRANGOLO, lindur ne Morbegno (Sondrio) me 27 mars 1976, banues per shkak te detyres ne Milano, Via Vittor Pisani 16, kod fiskal MTR MSO 76C27 F712C, regjistruar ne Regjistrin e Audituesve Ligjore me D.M. te 27 shkurtit 2007, publikuar ne Fletoren Zyrtare nr. 24 te 23 marsit 2007 – Anetar zevendesues i Keshillit Mbikeqyres.
- Dr. DAVIDE VILLA, lindur ne Piacenza me 27 qershor 1985, banues per shkak te detyres ne Milano, Via Vittor Pisani 16, kod fiskal VLL DVD 85H27 G535G, regjistruar ne Regjistrin e Audituesve Ligjore me D.M. te 2 shkurtit 2015, publikuar ne Fletoren Zyrtare nr. 13 te 17 shkurtit 2015 – Anetar zevendesues i Keshillit Mbikeqyres.

Te gjithë anetaret e Keshillit Mbikeqyres te emeruar, jane auditues ligjore te regjistruar ne regjistrin perkates. Pagesa vjetore e anetareve te Keshillit Mbikeqyres per tre vitet financiare te emerimit percaktohet te jete 4.500,00 euro (katerrmije e peseqind euro) per Kryetarin dhe 3.000,00 euro (tremije euro) per secilin nga 2 anetaret e tjere, pervec te shpenzimeve te ndryshme, shpenzimeve ligjore dhe T.V.SH-se.

Auditimi ligjor i llogarive te shoqerise do te ushtrohet per tre vitet e para financiare, pra deri ne miratimin e bilancit ne 31 dhjetor 2019, nga shoqeris “BDO Italia S.p.A.”, me seli ne Milano, Viale Abruzzi 94, me kapital prej 1.000.000,00 euro (nje milion euro), i shlyer teresisht, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Dhomes se Tregtise se Milanos me numer 07722780967 (R.E.A. 1977842), shoqeri e regjistruar ne Regjistrin e Audituesve Ligjore me nr. 167911 me D.M. te 15/03/2013 G.U. nr. 26 te 02/04/2013.

Pagesa vjetore e Audituesit Ligjor te llogarive percaktohet te jete 7.000,00 euro (shtatemije euro), pervec shpenzimeve te ndryshme, shpenzimeve ligjore dhe T.V.SH-se.

Ne perputhje me nenin 2475 te Kodit Civil n. 10, deklarohet se shuma totale e perafruar e shpenzimeve per themelimin te cilat i ngarkohen shoqerise mund te perllogaritet ne rreth pesemije euro.

Une Noteri kam marre kete akt, te cilin ua kam lexuar Zoterinjve Pjesemarres, te cilet e miratuan dhe nenshkruan ne oren dymbedhjete e pesembdhjete minuta.

Akti perbehet nga dy flete te vulosura, te shkruara nen kujdesin tim nga persona te besuar ne pese faqe te plota dhe pjese nga faqja e gjashte.

Nenshkruar ne origjinal:

FABIO FABIOLA

STEFANO BAROZZI

LORENZO ANSELMI NOTER

PROKURE E POSAÇME

.,.,.,.,.,.,.,.,.,.,.,.,.,.,.,.,.,.

REPUBLIKA E ITALISE

Viti dymije e shtatembdhjete, dita e shtatembdhjete e muajit mars ne Genova, Via Di Francia nje.

Perpara meje Doktor LORENZO ANSELMi Noter, regjistruar ne Dhomen e notereve te Genovas dhe Chiavarit, rezident ne Genova,

U paraqit Zoti:

- Thomas Walter HANSMANN, lindur ne Aachen (Gjermani) me 23 tetor 1961, banues per shkak te detyres prane shoqerise se permendur me poshte;

ne cilesine e Administratorit te Deleguar dhe, si i tille, perfaqesues ligjor i shoqerise "PAUL WURTH ITALIA S.P.A.", me seli ne Genova, via Di Francia 1, me kapital 1.000.000,00 euro (nje milion euro), regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Dhomes se Tregtise se Genovas me nr. 01559640998 (REA 4183456), i pajisur me tagrat e nevojshme te dhene me ane te vendimit te Keshillit te Administrimit te dates 22 dhjetor 2016.

Zoteria i paraqitur ne fjale, per identitetin personal te te cilit une noteri jam i sigurte, emerone dhe percakton perfaqesues te posaçem te shoqerise ne fjale zoterinjte:

- Fabio FABIOLA, lindur ne Camogli (Genova) me 24 nentor 1956, rezident ne via Bettolo 43/7 dhe
- Stefano BAROZZI, lindur ne Genova me 19 dhjetor 1956, rezident ne Via Felice Romani, 18/6

ne menyre qe, ne emerone dhe per llogari te shoqerise te perfaqesuar, te nenshkruajne, me nenshkrim te perbashket, te gjithë kapitalin themeltar te nje shoqerie perberese me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne Genova, via Di Francia 1 qe do te emerohet "PAUL WURTH ENERGY S.R.L." dhe do t ekete nje capital prej 300.000,00 euro (treqind mije euro); shoqeria ne fjale do te kete si objekt:

- a) ndertimi, instalimi, shitja dhe perfaqesimi i prodhimeve dhe impianteve elektrike dhe elektronike dhe ne cdo rast te sistemeve te lidhura, te integruara dhe te pershtatshme dhe /ose te bashkeveprimit;
- b) projektimi, instalimi, mirembajtja dhe asistenca e impianteve industriale dhe civile te ajrimit, te ngrohjes, prodhimit dhe kursimit te energjise, djegjes se mbetjeve urbane dhe substancash te tjera;
- c) tregtimi ne te gjitha format me shumice dhe pakice te produkteve, perfitimi i pjesemarrjeve ne shoqeri italiane ose te huaja, te gjithë produkteve e makinerive dhe pajisjeve te nderlidhura me sektorin;
- d) prodhimi i energjise, ne te gjitha format e saj, tregtimi, shitja, shperndarja, transmetimi i energjise ose transmetuesve energjetike te cfaredo natyre, menaxhimi i impianteve te prodhimit ose rikuperimit te energjise, te bashkegjenerimit, te furnizuarit si nga burime konvencionale ashtu edhe nga burime te rinovueshme dhe te perziera.

Shoqeria mund të marrë persiper dhe cedeje agjenci, komisionie, perfaqesime, me ose pa depozita, dhe mandate, të bleje, perdore, dhe transferoje patenta dhe vepra të tjera të krijimtarisë njerezore, të zhvillojë kerkime të tregut dhe të perpunojë të dhëna për llogari të saj ose për llogari të paleve të treta, të cedeje dhe të marrë licenca të shfrytëzimit tregtar si dhe të kryeje të gjitha veprimet tregtare (edhe import-export), financiare, me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. të nevojshëm ose të dobishëm për arritjen e objektit të shoqërisë.

për arritjen e objektit të shoqërisë dhe në çdo rast jo në mënyrë paresore, shoqëria mundet:

- a) të kryeje të gjitha veprimet tregtare, me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, industriale dhe financiare të konsideruara të dobishme nga Këshilli i Administrimit për arritjen e objektit të shoqërisë, përfshirë dënimin e garancive reale dhe/ose personale të cfarëdo lloji në favor të paleve të treta;
- b) të zotërojë, në Itali ose jashtë vendit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrje dhe/ose interesa në shoqëri të tjera dhe/ose ente tregtare, industriale dhe/ose shërbimesh që kanë qëllim analoge ose të ngjashme me ato të shoqërisë ose në çdo rast kur konsiderohet e nevojshme ose e dobishme për arritjen e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, dhe të menaxhojë pjesëmarrjet dhe/ose interesat në fjalë;
- c) të marrë financime nga aksionaret, pa shpërblim ose me shpërblim, duke respektuar normën e zbatueshme.

Në çdo rast, shoqëria përjashtohet shprehimisht nga mbledhja e kursimeve të publikut dhe veprimtaritë e kreditimit në kuptim të ligjit nr. 385 datë 1 shtator 1993 (i ndryshuar). veprimtari dorezanie, veprimtaritë sipas ligjit nr. 1815 datë 23 nëntor 1939 (i ndryshuar), ushtrimi profesional ndaj publikut i shërbimeve të investimit sipas ligjit nr. 58 datë 24 shkurt 1998 (i ndryshuar), veprimtaritë e ndërmjetësimit financiar ushtrimi i të cilave u lejohet subjekteve të autorizuar sipas nenit 196 i ligjit nr. 385 datë 1 shtator 1993, veprimtaria e ndërmjetësimit dhe konsulencës për dënimin e financimeve nga ana e bankave ose të ndërmjetësimeve financiare sipas nenit 16 i ligjit nr. 108 datë 7 mars 1996 (i ndryshuar) dhe cfarëdo veprimtari tjetër që ligjet në fuqi i rezervojnë për profesionistët e regjistruar në regjistra ose në çdo rast të cilat u nënshtrohen autorizimeve ose licencimeve të veçanta.

Perfaqësuesit e posaçëm të emëruar, autorizohen për të nderhyrë, me nënshtet të përbashkët, në aktin e themelimit përkatës, duke përfshirë aty, të gjitha paktet, klauzolat dhe kushtet me të pershtatshme dhe në veçanti klauzolat statutores të shoqërisë dhe eventualisht duke integruar ose modifikuar objektin e veprimtarisë, emëruar organet administrative – me mundësinë e shprehur për t'u vetë emëruar, si dhe për të emëruar Dr. Walter HANSMANN, si administratore -, duke u dhënë atyre kompetencat që do të konsiderohen me të pershtatshmet dhe duke kryer në pergjithësi, në lidhje me sa më sipër, cfarëdo veprimi tjetër të dobishëm ose të nevojshëm për përbushjen e këtij autorizimi,

Duke u zotuar për miratimit dhe vlefshmerinë

Me lirine për të kontraktuar me veten e vet por duke evituar konfliktin e interesit

Për t'u përbushur në një kontekst të vetëm.

Une noteri kam marrë këto akt, të cilin ia lexova Zotërisë së paraqitur, i cili e miratoi dhe nënshtet.

Perbehet nga 2 gjysme flete te vulosura, te shkruara nen kujdesin tim nga persona te besuar ne tre faqe te plota dhe pjese nga e katerta.

Nenshkuar ne origjinal

THOMAS WALTER HANSMANN

LORENZO ANSELMI NOTER



STATUTI
EMERTIMI, SELIA, OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA

Neni 1.) Emertimi

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin:

"PAUL WURTH ENERGY S.R.L."

Neni 2.) Selia

Shoqeria e ka seline ne Genova.

Shoqeria mund te themeloje diku tjeter, qofte ne Itali apo jashte saj, adresa dytesore, filiale, dege, zyra, depozita, perfaqesi dhe njesi lokale ne pergjithesi.

Neni 3.) Objekti

Shoqeria ka per objekt si me poshte:

- a) ndertimi, instalimi, shitja dhe perfaqesimi i prodhimeve dhe impianteve elektrike dhe elektronike dhe ne cdo rast te sistemeve te lidhura, te integruara dhe te pershtatshme dhe /ose te bashkeveprimit;
- b) projektimi, instalimi, mirembajtja dhe asistenca e impianteve industriale dhe civile te ajrimit, te ngrohjes, prodhimit dhe kursimit te energjise, djegjes se mbetjeve urbane dhe substancash te tjera;
- c) tregtimi ne te gjitha format me shumice dhe pakice te produkteve, perfitimi i pjesemarrjeve ne shoqeri italiane ose te huaja, te gjithe produkteve e makinerive dhe pajisjeve te nderlidhura me sektorin;
- d) prodhimi i energjise, ne te gjitha format e saj, tregtimi, shitja, shperndarja, transmetimi i energjise ose transmetuesve energjetike te cfaredo natyre, menaxhimi i impianteve te prodhimit ose rikuperimit te enrgjise, te bashkegjenerimit, te furnizuarit si nga burime konvencionale ashtu edhe nga burime te rinovueshme dhe te perziera.

Shoqeria mund te marre persiper dhe cedoje agjenci, komisionie, perfaqesime, me ose pa depozita, dhe mandate, te bleje, perdore, dhe transferoje patenta dhe vepra te tjera te krijimtarise njerezore, te zhvilloje kerkime te tregut dhe te perpunoje te dhena per llogari te saj ose per llogari te paleve te treta, te cedoje dhe te marre licenca te shfrytezimit tregtar si dhe te kryeje te gjitha veprimet tregtare (edhe import-export), financiare, me pasuri te luajshme dhe te paluajshme. te nevojshem ose te dobishme per arritjen e objektit te shoqerise.

per arritjen e objektit te shoqerise dhe ne cdo rast jo ne menyre paresore, shoqeria mundet:

- a) te kryeje te gjitha veprimet tregtare, me pasuri te luajtshme, te paluajtshme, industriale dhe financiare te konsideruara te dobishme nga Keshilli i Administrimit per arritjen e objektit te shoqerise, perfshire dhenien e garancive reale dhe/ose personale te cfaredo lloji ne favor te paleve te treta;
- b) te zoteroje, ne itali ose jashte vendit, drejtpersedrejti ose terthorazi, pjesemarrje dhe/ose interesa ne shoqeri te tjera dhe/ose ente tregtare, industriale dhe/ose sherbimesh qe kane qellim analoge ose te ngjashme me ate te shoqerise ose ne çdo rast kur konsiderohet e nevojshme ose e dobishme per arritjen e objektit te veprimtarise se shoqerise, dhe te menaxhoje pjesemarrjet dhe/ose interesat ne fjale;
- c) te marre financime nga aksionaret, pa shperblim ose me shperblim, duke respektuar normen e zbatueshme.

Ne çdo rast, shoqeria perjashtohet shprehimisht nga mbledhja e kursimeve te publikut dhe veprimtarite e kreditimit ne kuptim te ligjit nr. 385 date 1 shtator 1993 (i ndryshuar). veprimtari dorezanie, veprimtarite sipas ligjit nr.1815 date 23 nentor 1939 (i ndryshuar), ushtrimi profesional ndaj publikut i sherbimeve te investimit sipas ligjit nr. 58 date 24 shkurt 1998 (i ndryshuar), veprimtarite e ndermjetesimit financiar ushtrimi i te cilave u lejohet subjekteve te autorizuar sipas nenit 196 i ligjit nr. 385 date 1 shtator 1993, veprimtaria e ndermjetesimit dhe konsulences per dhenien e financimeve nga ana e bankave ose te ndermjetesimeve financiare sipas nenit 16 i ligjit nr. 108 date 7 mars 1996 (i ndryshuar) dhe cfaredo veprimtari tjeter qe ligjet ne fuqi i rezervojne per profesionistet e regjistruar ne regjistra ose ne çdo rast te cilat u nenshtrohen autorizimeve ose licencimeve te veçanta.

Neni 4.) Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise vendoset deri ne 31 dhjetor 2050.

Neni 5.) Libri i ortakeve

Shoqeria mban, nepermjet administratoreve, me te njejten menyre te percaktuar me ligj per librat e tjere te shoqerise, librin e ortakeve, ne te cilin duhet te tregohen emri dhe vendbanimi i ortakeve, kuotat e gjithesecilit, pagesat e bera mbi kuotat, ndryshimet tek ortaket, si dhe, aty ku komunikohen, adresen faks dhe adresen e tyre elektronike, deri ne fund te percaktuar sipas ketij statuti.

Vendbanimi i ortakeve, ne lidhje me marrredheniet me shoqerine, eshte ai qe rezulton nga regjistri i ortakeve.

KAPITALI DHE PJESEMARRJA

Neni 6.) Kapitali

Kapitali themeltar perbehet nga 300.000 euro (treqind mije euro).

Me perjashtim te rastit te zmadhimit te kapitalit sipas Nenit 2482 te Kodit Civil, kapitali mund te zmadhohet duke u ofruar aksione te reja paleve te treta vetem me pelqimin e te gjithe ortakeve.

Neni 7.) Kontributet dhe financimi

Kontributet e ortakeve mund te kene si objekt te tyre çdo element pasuror te lejuar nga ligji.

Ortaket mund te financojne shoqerine me pagesa me interes ose pa interes, per llogari te kapitalit ose te ndonje titulli tjetër, gjithashtu me detyrimin e rimbursimit, ne perputhje me dispozitat aktuale normative dhe rregullatore, ne perputhje me dispoziten e nenit 2467 c.c ..

Shoqeria, me vendim te asamblese se ortakeve, mund te leshoje letra me vlere te borxhit, ne kushtet dhe brenda kufijve te percaktuar me ligj.

Neni 8.) Pjesemarrja

Pjesemarrja ne shoqeri perfaqeson nje kuote te kapitalit.

Ne rastin e shume ortakeve, per nje periudhe prej pese vjetesh duke filluar nga data e aktit per efekt te te cilit do te kete me shume ortake, asnje ortak nuk do te jete ne gjendje te transferoje kuoten e zoteruar prej tij ne perputhje me parashikimet e nenit 2469, paragrafi 2, i c.c., me perjashtim te transferimeve si rezultat i te cilave nje ortak behet ortak i vetem.

Pas afatit te lartpermendur pesevjeçar, kuotat jane te transferueshme brenda kufijve te meposhtem.

Ne rastin e transferimit te titullit me ose pa interesa per palet e treta, duke perfshire ato mortis causa, te kuotave te pjesemarrjes, uzufruktit, pronesise se zhveshur ose te drejtave te tjera mbi to, secili ortak ka te drejten e parablerjes ne perpjesetim me kuoten e pjesemarrjes tashme te zoteruar, qe do te ushtrohet brenda tridhjetete diteve pas njoftimit te nje oferte per parablerje. Prandaj, perveç rastit ne te cilin te gjithë ortaket e tjere kane komunikuar heqjen dore, me shkrim, per te drejten e parablerjes, ortaku qe synon te transferoje pjesen e tij te kapitalit duhet t'i komunikojte te gjithë ortakeve te tjere dhe organit administrativ me leter rekomande, te derguar ne adresen e secilit prej tyre (kuptohet se ne rastin e transferimit mortis causa komunikimi do te behet nga organi administrativ ne emrin dhe per llogari te trashegimtareve brenda 30 diteve nga data ne te cilen keto te fundit njoftojne me shkrim organin administrativ per vdekjen e trashegimlensesit dhe cilesine e tyre te trashegimtarit); njoftimi duhet te permbaje gjeneralitetet e trashegimlensesit dhe kushtet e trashegimise, duke perfshire, ne veçanti, çmimet dhe modalitetet e pageses. Ortaket marres te njoftimit te mesiperme duhet te ushtrojne te drejten e parablerjes per te blere kuoten se ciles i referohet njoftimi, duke i derguar ortakut ofertues si dhe organit administrativ deklaraten e ushtrimit te se drejtes se parablerjes brenda (30) tridhjetete diteve pas njoftimit te lartpermendur.

Ne rast te ushtrimit te se drejtes se parablerjes nga ana e nje apo me shume ortakeve, kuota do t'u ofrohet ortakeve ne proporcion me vleren nominale te kuotes qe secili prej tyre posedon me te drejten e zmadhimit. Nese çmimi i kerkuar konsiderohet i tepruar nga ndonje prej ortakeve qe ka ushtuar, ne termat dhe ne format e mesiperme, vullnetin per te ushtuar te drejten e parablerjes ose ne rast te transferimit ne te cilin nuk eshte dhene shprehimisht ndonje konsiderate (p.sh. transferimi pa pagese ose per qellimin e dhenies ose mortis causa), çmimi i transferimit do te percaktohet nga ortaket me marreveshje te perbashket midis tyre, perveç ne rastin e transferimit per nje çeshtje mortis causa. Nese nuk arrihet ndonje marreveshje ose ne rast te transferimit mortis causa, percaktimi i çmimit do t'i delegohet nje arbitri te vetem te caktuar sipas kriterave te percaktuara ne nenin 25 te ketij Statuti. Ne percaktimin e tij, arbitri duhet te marre parasysh

gjendjen pasurore te Shoqerise, te perfitimit te saj, vleren e pasurive materiale dhe jomateriale ne pronesi te saj, te pozicionit te saj ne treg dhe te çdo rrethane dhe kusht tjeter qe vjen normalisht per qellimet e percaktimit te vleres se kontributeve te shoqerive. Ne rast te moszbatimit te drejtes se parablerjes, hyrja e anetareve te rinj, edhe nepermjet mortis causa, si dhe hyrja e mbajtesve te drejtave reale te shfrytezimit ose te garancise, ne çdo rast i nenshtrohet thjesht miratimit te shprehur nga asambleja e ortakeve, ne te cilen ortaku i interesuar per transferimin ka te drejte vote, te miratuar me ane te nje votimi pro prej me shume se gjysmes se kapitalit te nenshkruar. Per kete qellim, Keshilli i administrimit, ose ne mungese te tij, keshilli mbikeqyres duhet te therrase asamblene brenda 30 diteve nga paraqitja e aktit te transferimit ne regjistrin e shoqerise. Ne rast te refuzimit te miratimit, ortaket e tjere ose shoqeria do te blejne pjesen e ortakut kundrejt shperblimit ose ndaj trashegimtareve (apo t'i ofrojne te njejtat kushte nje pale te trete per blerje) me çmimin e deklaruar ne klauzolat e mesiperme ose te beje te mundur anullimin. Transfertat (edhe te pjesshme) te çdo lloji midis ortakeve apo qe ndodhin ne favor te personave te kontrolluar nga ortaku qe synon te vazhdoje me transferimin ose shoqerise qe kontrollon ose kontrollohet nga i njejt i subjekt qe kontrollon ortaku, ne perputhje me nenin 2359, paragrafi 1, c.c., gjithashtu edhe nepermjet shoqerive te tjera te nderlidhura, jane te lira dhe nuk i nenshtrohen klauzolave aktuale te se drejtes se parablerjes dhe miratimit. Ne rast te nderprerjes se marredhenies se kontrollit, kuotat duhet te kthehen brenda 10 diteve nga kjo ngjarje. Per sa kohe qe kjo gje nuk ndodh, te drejtat sociale te lidhura me keto kuota nuk do te jene te ushtrueshme. Ne rastin e transferimit nga nje prej anetareve te te gjithes ose nje pjese te kuotes se tij ne shkelje te procedurave per te drejten e parablerjes ose procedurat e miratimit te percaktuara ne nenin 8 apo edhe ne qofte se nuk do te behet ri-transferim sipas paragrafit me siper, pala e trete blerese – qe ushtron pa kufizim te drejtat sociale ne lidhje me kuoten e fituar - mund te perjashtohet nga Shoqeria ne perputhje me nenin 2473 te Kodit Civil.

Neni 9.) Heqja dore e ortakeve

Ortaket kane te drejte te heqin dore ne rastet dhe me efektet e percaktuara me ligj. Heqja dore ushtrohet nepermjet nje letre rekomande te derguar shoqerise.

Ne varesi te rasteve ne te cilat kjo e drejte nuk varet nga ndodhja e nje shkakut te caktuar, dergesa e regjistruar duhet te behet, ne dekadence, brenda pesembedhjete diteve nga: (a) regjistrimi ne regjistrin e shoqerive te vendimit sipas rastit; ose (b) nga momenti qe ortaku ka pasur njohuri per shkakun e heqjes dore, nese shkakun specifik nuk konsiston ne nje vendim.

Organi administrativ eshte i detyruar t'i komunikojte ortakeve faktet qe mund te legjitimojne te drejten e heqjes dore brenda tridhjete diteve nga data ne te cilen kjo e drejte ka lindur. Heqja dore nuk mund te ushtrohet dhe, nese tashme eshte ushtruar, nuk ka efekt nese, brenda nentredhjete ditesh pas ushtrimit te heqjes dore, shoqeria revokon vendimin qe e legjitimon apo nese eshte vendosur prishja e shoqerise.

Pa cenuar dispozitat e nenit 8 dhe subjekt i shkakut te perjashtimit te parashikuar nga ligji, nuk ka baze formale per perjashtim te ortakeve.

Ne rastet e heqjes dore ose perjashtimit, nese nuk bihet dakord ndryshe ndermjet te gjithes ortakeve, vlera e kuotes do te percaktohet ne perputhje me nenin 8 me siper, mutatis mutandis.

ASAMBLEJA DHE VENDIMMARRJA EORTAKEVE

Neni 10.) Mbledhja

Asambleja mbledhet edhe individualisht nga secili administrator, edhe ne rastin e organit administrativ kolegjal, sipas gjykimit te saj ose detyrimisht me kerkese te nje ose me shume ortakeve qe perfaqesojne te pakten nje te terten e kapitalit.

Mbledhja e asamblese njoftohet me leter rekomande te derguar ortakeve ne adresen qe rezulton nga regjistri i ortakeve se paku tete dite para mbledhjes, ose me faks ose e-mail te derguar se paku pese dite perpara mbledhjes, me kusht qe te jene regjistruar ne librin e ortakeve, me kerkesen e tyre, numri i marresit te faksit ose adresa e-mail.

Mbledhja e ortakeve mund te mbahet edhe jashte selise, me kusht qe te jete ne nje vend te Bashkimit Evropian ose ne Zvicer.

Ne njoftimin e takimit duhet te tregohet dita, vendi, ora e takimit dhe lista e ceshtjeve per t'u diskutuar.

Ne njoftimin e mbledhjes mund te jepet nje date e mevonshme e thirrjes se dyte, ne rast kur per mbledhjen e planifikuar per thirrjen e pare asambleja nuk eshte mbledhur ne menyre te ligjshme.

Edhe ne mungese te formalitetit te mbledhjes, asambleja konsiderohet te jete mbledhur rregullisht dhe mund te vendose ne menyre te vlefshme ne prani te kushteve te kerkuara nga ligji.

Neni 11.) Pjesemarrja dhe votimi

Ata qe jane ortake sipas te dhenave te regjistrimit te shoqerise kane te drejte te marrin pjese ne mbledhjet e Asamblese. Secili ortak me te drejte pjesemarrjeje mund te perfaqesohet, madje edhe nga nje jo ortak, me kusht qe prokura te leshohet me shkrim dhe dokumentet perkatese duhet te jene te mbajtura nga shoqeria ne perputhje me nenin 2372 c.c. Eshte ne dore te kryetarit te mbledhjes te caktojte te drejten per te marre pjese ne mbledhje me ane te prokures.

Asambleja mund te zhvillohet me pjesemarrje te vendosur ne vende te ndryshme, fqinj ose te larget, audio/video konference, me kusht qe te respektohet metoda kolegjiale dhe parimet e mirebesimit dhe barazise se trajtimit te anetareve, dhe ne vecanti me kushtin qe: (a) kryetari i asamblese te lejohet te kryesoje takimin edhe permes zyres se tij, per te konstatuar identitetin dhe legjitimitetin e pjesemarrjesve, rregullon takimin, konstaton dhe shpall rezultatet e votimit; (b) i lejohet subjektit foles ne menyre adekuate te perceptoje ngjarjet e mbledhjes qe i nenshtrohen diskutimit; (c) pjesemarrjesve u lejohet te marrin pjese ne diskutim dhe votim te njekohshem ne rendin e dites. Takimi konsiderohet te mbahet ne vendin ku jane te pranishem kryetari dhe personi qe mban procesverbalin.

E drejta per te votuar i takon ortakeve ne masen qe parashikohet ne ligj.

Neni 12.) Kryetari, Kryetari i nderit dhe procesverbali

Mbledhja drejtohet nga administratori i vetem ose nga kryetari i keshillit te administrimit, ose, ne rast te nje vendimi tjeter nga shumica e pjesemarrjesve, nga nje person i caktuar nga vete asambleja.

Mbledhja e asamblese regjistrohet ne nje procesverbal te hartuar nga sekretari, i emeruar nga vete asambleja dhe nenshkruar nga ai si dhe nga kryetari.

Asambleja e zakonshme mund te vazhdoje me emerimin e nje kryetari me detyra nderi. Kryetari i nderit nuk eshte anetar i keshillit te administrimit. Kryetari i nderit qendron ne detyre per te njejten kohe me kohezgatjen e keshillit te administrimit dhe qendron deri ne doreheqjen ose revokimin, me mbarimin e keshillit te administrimit. Kryetari te nderit do t'i caktohen vetem funksione per te perfaqesuar shoqerine ne ngjarje te ndryshme nga ato tipike te aktivitetit te shoqerise, siç jane ngjarjet kulturore apo perfitimet. Kryetarit te nderit nuk i eshte besuar nenshkrimi dhe perfaqesimi i shoqerise. Kryetari i nderit nuk ka te drejte te marre shperblime, perveç te drejtes per rimbursim te shpenzimeve te bera per aktivitetet e kryera ne favor te shoqerise.

Ne rastet e parashikuara ne ligj dhe kur organi administrativ ose kryetari i asamblese se ortakeve e konsideron te pershtatshme, procesverbali perpilohet nga nje noter. Ne kete rast asistenca e sekretarit nuk eshte e nevojshme.

Neni 13.) Konsultimet dhe miratimi me shkrim

Vendimet e ortakeve mund te merren, brenda kufijve te parashikuar nga ligji, edhe nepermjet konsultimeve me shkrim ose ne baze te miratimit me shkrim, me kusht qe te respektohen parimet e mirebesimit dhe te barazise se trajtimit te ortakeve, dhe ne veçanti me kusht qe: (a) nga dokumentet e nenshkruara nga ortaket rezulton i qarte argumentimi i rendit te dites, vendimi dhe miratimi; (b) secili anetar mund te marre pjese ne vendimmarrje dhe te gjithe administratoret dhe kryetaret, nese jane emeruar, jane te informuar ne menyre adekuate per vendimin qe duhet te merret; (c) eshte siguruar marrja e dokumenteve te nenshkruara ne aktet e shoqerise dhe regjistrimi i vendimeve ne librat e shoqerise, duke shenuar daten ne te cilen eshte vendosur dhe ne te cilen eshte regjistruar; (d) te respektohet e drejta, per sa i perket administratoreve dhe ortakeve ne baze te nenit. 2479 te c.c., per te kerkuar qe vendimi te miratohet ne asamblene e ortakeve.

Neni 14.) Shumica

Vendimet e asamblese dhe vendimet e ortakeve (edhe kur merren me konsultim me shkrim dhe me miratimin me shkrim) merren me votimin ne favor nga shumica e kapitalit te nenshkruar.

ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

Neni 15.) Administratoret

Shoqeria mund te administrohet, ne menyre te alternuar, me vendimin e ortakeve sipas emerimit te tyre: (a) nga nje administrator i vetem; (b) nga nje keshill administrimi i perbere nga dy ose me shume anetare; (c) nga dy ose me shume administratore (qe nuk perbejne nje trup kolegjal) me kompetenca te perbashketa ose te ndara, ne varesi te asaj qe do te vendoset nga ortaket ne kohen e emerimit.

Ne rast se emerohen dy ose me shume administratore pa ndonje percaktim ne lidhje me menyren e ushtrimit te kompetencave te administrimit, duhet te themelohet nje keshill i administrimit.

Me organ administrativ kuptojme, sipas rastit, administratorin e vetem, keshillin e administrimit, ose te gjithë administratoret vecmas ose se bashku.

Neni 16.) Dispozita te perbashketa per administratoret

Administratoret nuk mund te jene ortake, mund te rizgjidhen dhe i nenshtrohen ndalimit te konkurrences ne perputhje me nenin 2390 te K.C..

Administratoret emerohen per afatin e caktuar nga ortaket ose per nje afat te pacaktuar dhe mund te revokohen ne çdo kohe nga ortaket.

Ata shkarkohen nga detyra ne rastet e parashikuara nga ligji.

Administratoreve u takon e drejta e rimbursimit te shpenzimeve te bera per arsye te detyres se tyre.

Ortaket mund te caktojne per administratoret nje pagese vjetore fikse, ose nje shperblim proporcional me fitimet neto te vitit, dhe te percaktoje nje demshperblim per nderprerjen e detyres si dhe te vendose per sigurimin per fondin perkates te pensionit me procedurat e percaktuara me vendim te ortakeve.

Ne rast te emerimit te nje ose me shume administratoreve te deleguar, kompensimi i tyre percaktohet nga keshilli i administrimit ne kohen e emerimit.

Kuptohet qe nese ne kohen e emerimit te nje administratori ose te nje administratori te deleguar nuk vendoset njekohesisht ndonje shperblim, funksioni, perveç kur vendoset ndryshe, do te konsiderohet falas dhe, ne kete rast, duke pranuar emerimin, administratori ose administratori i deleguar gjithashtu bie dakord te heqe dore nga cdo shperblim, me perjashtim te rimbursimit te shpenzimeve.

Neni 17.) Administratori i vetem

Administratori i vetem ka te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem, pervec atyre te kerkuara me ligj.

Neni 18.) Keshilli i administrimit

Ne qofte se ortaket nuk kane qene te pranishem ne kohen e emerimit, keshilli i administrimit zgjedh nga anetaret e tij nje kryetar dhe sipas rastit nje ose me shume zevendes kryetar dhe/ose nje ose me shume administratore te deleguar. Nese gjate vitit nuk paraqiten nje ose me shume administratore, te tjeret i zevendesojne ata me nje vendim te miratuar nga keshilli mbikqyres, nese emerohet, duke siguruar qe shumica te perbehet gjithmone nga administratoret e emeruar nga asambleja. Administratoret e emeruar ne kete menyre mbeten ne detyre deri ne mbledhjen e ardhshme te asamblese dhe ata te emeruar nga asambleja qendrojne ne detyre per kohen qe duhet te qendronin administratoret qe ata zevendesuan.

Megjithate, kur gjate nje mbledhjeje mungojne per shkak te doreheqjes ose per nje arsye tjeter te pakten dy nga anetaret e keshillit te administrimit, do te konsiderohet se mungon i gjithë keshilli. Administratoret qe nuk kane dhene doreheqjen mbeten ne detyre per qellimin e vetem te thirrjes pa vonese te asamblese se ortakeve per emerimin e ri dhe per veprimet e zakonshme administrative.

Kryetari ose çdo anetar tjetër i keshillit të administrimit therrasin keshillin e administrimit, duke vendosur rendin e dites, dhe duke siguruar që të gjithë administratorët janë të informuar siç duhet për rendin e dites.

Takimi bëhet me anë të një njoftimi drejtuar të gjithë administratorëve dhe kryetareve, qoftë të emeruar, në çdo mënyrë të pershtatshme për të siguruar prova të pranimit, të pakten tre dite para mbledhjes dhe, në raste urgjente, të pakten një ditë përpara.

Në njoftim tregohet data, ora, vendi i mbledhjes dhe rendi i dites.

Keshilli mbledhet në aty ku është selia ose edhe diku tjetër, me kusht që të jetë një vend i Bashkimit Evropian ose në Zvicër.

Mbledhjet e keshillit dhe vendimet e tij janë të vlefshme, edhe pa thirrjen formale, kur marrin pjesë të gjithë administratorët dhe kryetaret në detyrë në qoftë se emerohen, dhe të gjithë ata që kanë të drejtë të marrin pjesë janë informuar paraprakisht për mbledhjen edhe pa formalitetet e kerkuara për mbledhjen.

Takimi kryesohet dhe menaxhohet nga kryetari i keshillit të administrimit ose nga personi i emeruar nga shumica e të pranishmeve.

Mbledhjet e keshillit të administrimit mund të zhvillohen edhe nepermjet audio ose video konferencës, me kusht që: (a) të jenë të pranishëm në të njëjtin vend kryetari dhe sekretari i takimit, nëse është caktuar, do të sigurojë mbajtjen dhe nënshkrimin e procesverbalit, duke marrë parasysh mbledhjen e mbajtur në atë vend; (b) kryetari i mbledhjes konstaton identitetin e të pranishmeve, rregullon ecurinë e mbledhjes, konstaton dhe shpall rezultatet e votimit; (c) mbajtësi i procesverbalit shenon në mënyrën e duhur mbledhjen që është subjekt i procesverbalit; (d) pjesëmarrësit lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe njëkohësisht të votojnë për rendin e dites, si dhe të shikojnë, pranojnë ose të japin dokumente.

Për vlefshmerinë e vendimeve të keshillit të administrimit, të marra në mbledhjen e tij, kërkohet prania efektive e shumicës së anetareve të tij në detyrë; vendimet merren me shumicën absolute të votave të të pranishmeve. Në rast të barazisë së votave, propozimi konsiderohet i refuzuar.

Për vendimet e marra në mbledhje mbahet një procesverbal, i firmosur nga kryetari dhe sekretari, të cilat do të regjistrohen librin e vendimeve të administratorëve.

Vendimet e keshillit të administrimit, brenda kufijve të percaktuar me ligj, gjithashtu mund të miratohen me konsultim me shkrim ose në bazë të miratimit të dhënë me shkrim, me kusht që: (a) çdo administratori i garantohet e drejta për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe e drejta për të marrë informacionin e nevojshëm; (b) nga dokumentet e nënshkruar nga administratorët del qartë objekti i vendimit dhe miratimi i saj, nga shumica e administratorëve në detyrë; (c) vendimet regjistrohen pa vonesë në librin e vendimeve të administratorëve dhe dokumentet perkatese mbahen në regjistrat e shoqërisë; (d) të pakten dy administratorë mund të kërkojnë miratimin e një vendimi në një mbledhje kolegjiale.

Keshili i administrimit ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, pa asnjë kufizim, përveçse atyre të kerkuara me ligj.

Keshilli i administrimit mund të delegojë, brenda kufijve të percaktuar me ligj, kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, ose një pjesë të tyre, tek një ose më shumë administratorë të deleguar, si edhe tek një komitet ekzekutiv.

Per te gjitha ato qe nuk jane percaktuar nga statuti aktual ne sferen e veprimit te keshillit te administrimit, zbatohen. per aq sa jane te pajtueshme, rregullat e parashikuara ne çeshtjen e shoqerise per veprim.

Neni 19.) Administratore te vecante ose te perbashket

Ne rast te emerimit te shume administratoreve, pa krijimin e nje keshilli te administrimi, ushtrojne te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem, pa asnje kufizim, pervec cfare eshte parashikuar nga ligji.

Vendimi i emerimit percakton nese keto kompetenca ushtrohen, ne teresi ose pjeserisht, vecmas, se bashku nga te gjitha, ose se bashku nga dy ose me shume administratore, nepermjet shumices ose ne nje menyre tjeter.

Nese ne vendimin e emerimit nuk rezulton se kompetencat per te kryer nje lloj te caktuar te veprimeve te administratoreve vecmas, ne menyre te perbashket ose ne menyre tjeter, duhet te kuptohet se vendimi u takon te gjitha administratoreve ne menyre te perbashket.

Ne rastin e administrimit te perbashket, administratoret vecmas nuk mund te kryejne asnje veprim, pervec rasteve kur eshte e nevojshme te veprohet me urgjence per te parandaluar demtimin e shoqerise.

Ne qofte se administrimi u eshte ngarkuar jo bashkerisht shume administratoreve, ne rast te kundershimit nga nje administrator per veprimin qe nje tjeter ka per qellim te beje, mbi kete kundershtim vendosin te gjitha administratoret, me shumice.

Neni 20.) Perfaqesimi

Perfaqesimi i shoqerise, sipas rastit, behet nga: (a) administratori i vetem; (b) ne rast te emerimit te nje keshilli administrimi, kryetari i keshillit te administrimit dhe administratoret e vecante te deleguar, nese jane emeruar dhe brenda fusheveprimit dhe per ushtimin e detyrave qe u jane caktuar; (c) ose ne rastin e emerimit te disa administratoreve, administratoret se bashku ose vecmas, per ushtimin e kompetencave qe u jane caktuar, sipas nenit 19 me siper.

Perfaqesimi i shoqerise u takon gjithashtu drejtoreve, menaxhereve dhe perfaqesuesve ligjore, brenda kufijve qe u jane dhene ne aktin e emerimit per ushtimin e kompetencave te tyre.

Neni 21.) Organi i kontrollit dhe auditimi ligjor i llogarive.

Ne rastet kur e parashikon ligji ose nese e vendosin ortaket, shoqeria cakton nje organ kontrolli ose nje auditues. Organi i kontrollit mund te perbehet nga nje person ose mund te jete kolegjal, i ngritur nga tre auditues dhe dy zevendesues; audituesi mund te jete nje person fizik ose nje kompani auditimi.

Shoqeria gjithashtu mund te vendose t'ia besojte kontrollin mbi menaxhimin organit te kontrollit dhe auditimin ligjor te llogarive nje audituesi.

Siç u përmend me lart, kompetencat, funksionet, kohezgjatja dhe perberja e organit të kontrollit dhe të audituesit rregullohen, për atë që janë të pajtueshme, me rregullat e vendosura për shoqëritë në lidhje me veprimtarinë e saj.

Mbledhjet e organit kolegjial të kontrollit mund të mbahen me telekonferencë, ashtu siç parashikohet në rastin e keshillit të administrimit.

BILANCI – FITIMET – PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 22.) Pasqyrat financiare dhe bilanci

Pasqyrat financiare mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo viti ushtrimor, organi administrativ procedon me hartimin e bilancit sipas parashikimeve ligjore.

Bilanci i paraqitet ortakeve brenda 120 ditëve nga mbyllja e vitit financiar, ose brenda 180 ditëve nga kjo datë, brenda kufijve dhe sipas kushteve të përcaktuara me nenin. 2364, paragrafi 2, c.c ..

Neni 23.) Te ardhurat dhe dividendi

Fitimet që rrjedhin nga pasqyrat financiare të miratuara siç duhet, pas zbritjes së pjesës së caktuar për rezervën ligjore, mund të ndahen për rezervë ose t'u shpërndahen ortakeve, sipas kuotave përkatëse.

Neni 24.) Prishja e shoqërisë

Për çdo rast të prishjes së shoqërisë, aplikohen dispozitat ligjore.

Neni 25.) Dispozita e arbitrazhit

Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me marrëdhëniet e shoqërisë, duke përfshirë ato që lidhen me vlefshmerinë e vendimeve të ortakeve dhe duke përjashtuar vetëm ato që i referohen juridiksionit ekskluziv të Autoritetit Gjyqësor, të nisura nga ose kundër ortakeve, shoqërisë, administratoreve, kryetareve, audituesve ligjorë dhe likuiduesve do të zgjidhen nëpërmjet arbitrazhit sipas rregullave të Dhomes Kombëtare dhe Nderkombëtare të Arbitrazhit të Milanos.

Gjykata e Arbitrazhit do të përbehet nga një arbiter i vetëm i emëruar nga Dhoma e Arbitrazhit. Arbitrazhi do të jetë procedural dhe Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë sipas ligjit.

Pavarësisht nga dispozitat e këtij statuti, heqja e klauzoles së arbitrazhit duhet të miratohet nga ortaket që përfaqësojnë të paktën dy të tretat e kapitalit të shoqërisë; ortaket që mungojnë ose nuk bien dakord mund të jenë, brenda nëntëdhjetë ditëve të ardhshme, ta ushtrojnë të drejtën e heqjes dore.

Neni 26.) Dispozita referuese

Per cdo gje qe nuk parashikohet nga ky statut do te referohet ne dispozitat qe permban kodi civil italian dhe ne ligje te tjera ne fuqi.

Kopja origjinale nenshkuar nga:

FABIO FABIOLA

STEFANO BAROZZI

LORENZO ANSELMI NOTER

Agjencia e te Ardhurave Genova 2 – Regjistruar me Nr.3301

Seria 1T - ne daten 17/03/2017 Sakesisht 356,00 Euro



Kopje e njesuar me origjinalin nenshkuar sipas dispozitave ligjore

Genova 16 tetor 2017

PROKURORIA E REPUBLIKES
PRANE GJYKATES SE GENOVA

APOSTILE

(Konveta e Hages 5 tetor 1961)

1. Shteti: ITALI

Ky dokument publik

2. U nenshkrua nga: ANSELMIO LORENZO

3. Ne cilesine e: NOTERIT

4. Mban vulen e: ANSELMIO LORENZO DI ANSELMO NOTER NE GENOVA



VERTETON

5. ne GENOVA

6. me 16/10/2017

7. nga Prokuroria e Republikes prane Gjykates se Genova

8. me numer 4038/CIV/AP/2017

9. Vula [Prokuroria e Republikes prane Gjykates se Genova]

10. Nenshkrimi

ZV.PROKUROR I REPUBLIKES.

Dr. Elena Schiavetta

[nenshkrimi]


REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE

Dhoma e Noterise Tirane

N. 2710 rep

VERTETIM PERKTHIMI

Vertetoj une, Noteri, vertetoj nenshkrimin e Z / Znj. Besiana Nela.....
personalisht e njohur prej meje, e cila deklaroi se perktheu me korrektese sa me lart nga
gjuha Ituliane..... ne Shqip..... aktin bashkengjitur dhe garantoi
saktesine e perkthimit me nenshkrimin e tij / saj.



GENTIANA SHKODRA / NOTERE



